REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR
KËSHILLI DREJTUES NË RTSH

Nr.1947/22 Prot.

Tiranë, më 08.10.2026

VENDIM
NR. 49 DATË 08.10.2026

Në zbatim të nenit 102, të Ligjit nr. 97, datë 04.03.2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, nenit 17 të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 22.12.2016 *"Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)"*, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme me nr. 1947/21 prot., datë 29.09.2026, me lëndë *"Në lidhje me projektin artistik me titullin "Frekuenca e Mëngjesit""*, si dhe në vijim të procesverbalit të mbledhjes, mbajtur në datë 08.10.2026; nga ku Këshilli Drejtues pas procesit të rregullt të votimit dhe me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë preventivin financiar të projektit artistik me titull "Frekuenca e Mëngjesit", një program në llojin e ciklit të emisioneve televizive, një prodhim ekskluziv i RTSH-së, që transmetohet 5 herë në javë, për periudhën kohore tetor-dhjetor, nga dita e Hënë në të Premte, nga ora 07:00, deri në orën 09:00, në kanalin televiziv "RTSH 2 HD", në vlerën totale 2,202,000 (dymilionëedyqindedymijë) lekë, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen dhe marrjen e masave administrative e financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI DREJTUES

Z. Fatjon Hoxhalli	Kryetar
Z. Petrit Beci	Nënkryetar
Z. Enio Civici	Anëtar
Z. Pano Xhixho	Anëtar (kundër)
Z. Alket Braho	Anëtar (kundër)
Znj. Zamira Kita	Anëtar
Z. Lorenc Vangjeli	Anëtar (mungon)
Z. Bujar Kapexhiu	Anëtar
Z. Osman Mula	Anëtar (mungon)
Znj. Rajmonda Bulku	Anëtar
Z. Robert Budina	Anëtar (mungon)